

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për krime të rënda- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fllanza Kadiu, kryetare, Tonka Berishaj dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionale Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.D., për verën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK, duke vendosur me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarit, av. R.K. dhe av. M.H., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.13/2017, të dt.20.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, me datën 28.04.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të të akuzuarit B.D., av. R.K. dhe av.M.H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.13/2017, të dt.20.02.2017, përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarin B.D., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4(katër)vite dhe duke e marrë si të vërtetuar dënimin me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)€, konformë dispozitës së nenit 80 par. 1 të KPRK, e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve dhe me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)€. Dënimi me burgim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimin me gjobë i akuzuari është i obliguar që të paguajë duke filluar me pagesë 30ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.09.2016, deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit.

II. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

III. Refuzohet ankesa e prokurorit të prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, si e papabazuar.

## Arsy etimi

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.13/2017, të dt.20.02.2017, i akuzuari B.D., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale- blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK dhe për këtë veprë është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite dhe dënimin me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)€, me konstatim që dënimin me burgim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe me këtë dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.09.2016, deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit, ndërsa dënimin me gjobë i akuzuari është i obliguar që të paguajë duke filluar me pagesë 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe duhet të paguhet në tërësi jo më lart se 3(tre)muaj, nga koha e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në këtë rast, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke u llogaritur për çdo 20 € të gjobës së shqiptuar 1(një)ditë burgim.

I akuzuari është obliguar që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50€ dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20€, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të sendeve dhe atë narkotikut të llojit marihuan në sasi prej 48.578kg, një peshore digjitale, dorëza najloni, 22shirita ngjites dhe qese për mbështjelljen e narkotikëve të sekuestruar nga i akuzuari.

Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu ka shqiptuar edhe dënimin plotësues të akuzuarit-marrja e sendeve dhe atë urdhërohet konfiskimi i përhershëm i sendeve:249Euro, të cilat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të shkojnë në administrimin e agjencisë për Administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, ndërsa ka urdhëruar kthimin e sendeve: telefonin e tipit “HUAËEI”, një telefon të tipit “Nokia”, dhe një SIM kartelë të telefonit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor, ankesë kanë paraqitur:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i ashpër;

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.D., av.M.H., sipas autorizimit për shkak të vendimit lidhur me dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar lidhur me vendimin për dënimin të ndryshohet dhe të mbrojturit të tij ti shqiptohet një dënim më i butë me burgim dhe me të holla, ndërsa ankesa e prokurorit të refuzohet si e pabazuar dhe

-Mbrojtësi i të akuzuarit B.D., av.R.K., po ashtu lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të mbrojturit të tij ti shqiptohet një dënim më i butë me burgim dhe me gjobë.

Gjykata e Apelit seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ishin të pranishëm: mbrojtësi i të akuzuarit B.D., av.R.K., i cili mbeti në tërësi pranë ankesës dhe i akuzuari B.D., i cili e mbështeti ankesën e mbrojtësve të tij. Mbrojtësi i të akuzuarit av.M.H., me parashtresë të dt.24.04.2017, ka kërkuar nga gjykata që të shtyhet seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit, për shkak se të njëjtën ditë e ka të caktuar një gjykim në Gjykatën Themelore në Pejë, mirëpo, pas njoftimit të palëve me parashtresën e mbrojtësit dhe arsyetimin e tij, për shkak të pa mundësisë që të merr pjesë në seancë, i akuzuari është deklaruar dhe ka insistuar që seanca e kolegjit të mbahet duke theksuar se në seancë është i pranishëm mbrojtësi i tij, i cili e ka përcjellë rastin që nga fillimi. Në seancën e kolegjit mungoi edhe prokurori i Apelit, prandaj, gjykata seancën e kolegjit e mbajti konformë nenit 390 par.4 të KPPK, në mungesë të mbrojtësit të të akuzuarit av.M.H. dhe Prokurorit të Apelit.

Prokurori i Apelit të Kosovës me parashtresën PPA/I.nr.181/17, të datës 06.04.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në mënyrë që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burg efektiv sesa dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e ankimuar. Po ashtu ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit B.D., av.M.H. dhe av.R.K., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje penale juridike dhe aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarit të të akuzuarit B.D., janë të bazuara, ndërsa ankesa e prokurorit nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarit, atëherë Gjykata e Apelit, të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPK, sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Gjendja faktike e vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së parë, nuk ishte objekt i shqyrtimit sepse nuk ishte ankimuar, por as që lejohet ankesa për bazën ankimore nga neni 383 par.1 nën par.1.3 të KPPK, sepse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë është pajtuar trupi gjykses. Prandaj, gjykata u përqendrua në vlerësimin e pretendimeve ankimore lidhur me vendimin për dënimin.

Prokurori i PTH në Mitrovicë duke e ankimuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të vendimit për dënimin, pretendoi se gjykata e çështjes me rastin e matjes së dënimit nuk i ka vlerësuar në masën e duhur rrethanat rënduese që ishin të pranishme në anën e të akuzuarit siç janë: shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, rrethanat me të cilat është kryer vepra penale, rrezikshmërinë shoqërore duke pasur parasysh natyrën e këtyre veprave penale. Pretendon se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, ndaj të akuzuarit nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, i përcaktuar me Kodin Penal.

Ndërkaq mbrojtësit e të akuzuarit av.M.H. dhe av.R.K., në ankesë pretendojnë se dënimet janë mjaft të ashpra sidomos kur rrethanat rënduese të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, në fakt, paraqesin elementet konstitutive të veprës penale, ndërsa konstatimi se ky rast është rasti më i madh i kësaj natyre prej gjitha rasteve që është procedura në gjykatën në fjalë në asnjë mënyrë nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese dhe paraqesin argumentet e tyre duke i numruar aktgjykimet konkrete që vërtetojnë të kundërtën e asaj që ka konstatuar gjykata. Konsiderojnë se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit e ka nënvlerësuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari që në shqyrtimin fillestar edhe pse sipas ligjit kjo paraqet rrethanë veçanërisht lehtësuese sepse ky i akuzuar me pranimin e fajësisë e ka lehtësuar vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje. Përveç kësaj ata i referohen edhe rrethanave tjera lehtësuese si rrethanave familjare dhe ekonomike të cilat gjithashtu gjykata e shkallës së parë, i ka nënvlerësuar me rastin e shqiptimit të dënimit.

Sipas gjetjes së Gjykatës së Apelit pretendimet në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve janë të bazuara, ndërsa pretendimet ankimore të prokurorit nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana rënduese për të akuzuarin ka vlerësuar dashjen e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, e që nga rrethanat e rastit rrjedh se i akuzuari ishte i vetëdijshëm se posedimi i drogës me qëllim shitjeje, shpërndarjeje apo transporti është e ndaluar me ligj, përkundër kësaj ai e dëshironte veprën penale e që nënkupton se veprën penale e ka kryer me dashje direkte, pastaj shkallën e përgjegjësisë penale sepse i akuzuari ka vepruar me përgjegjësi dhe përgjegjshmëri të plotë, kontributin e të akuzuarit te kjo vepër penale sepse gjithë sasia e narkotikut-objekt i kësaj çështje ishte në posedim dhe nën kontroll të akuzuarit, rrezikshmëria që paraqet kjo vepër penale, veçanërisht qëllimi i shitjes dhe shpërndarjes së narkotikut, sasia shumë e madhe e narkotikut prej 48.578kg. me konstatim se ky është rasti më i madh i kësaj natyre në gjykatë që ka gjykuar. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, keqardhjen dhe pendimin e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të njëjta, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, moshën shumë të re, faktin se është familjar, baba i dy fëmijëve dhe i gjendjes së dobët ekonomike.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rrethanat rënduese të vlerësuara të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, përveç shkallës së përgjegjësisë penale, paraqesin elementin konstitutiv të veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, ashtu si me të drejtë pretendojnë edhe mbrojtësit e të akuzuarit. Në fakt, dashja paraqet elementin subjektiv të veprës penale në kuptim të dispozitës së nenit 17 par. 1 të KPRK, dispozitë kjo që ka përcaktuar nocionin e përgjegjësisë penale:” kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje ose nga pakujdesia”. Pastaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rrezikshmëria shoqërore e veprës së kryer penale nuk mund të trajtohet si rrethanë rënduese, edhe pse intensiteti i rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, në çdo rast konkret, ka ndikësë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Posedimi, kontrolli dhe qëllimi i shitjes janë elementet e veprës penale, ndërsa sasia e narkotikut paraqet element kualifikues sipas kualifikimit të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 281 par. 1 nën par. 1.9 të KPRK.

Me të drejtë mbrojtësit e të akuzuarit pretendojnë se fakti i konstatuar dhe i vlerësuar si rrethanë rënduese në aktgjykimin e ankimuar se ky është rasti më i madh që është gjykuar në gjykatën e çështjes për shkak të sasisë së narkotikut nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese sepse, ashtu si u tha edhe më parë, sasia e narkotikut paraqet element kualifikues të veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor.

Rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë i pranon edhe kjo Gjykatë, mirëpo gjen se me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit këto rrethana janë nënvlerësuar, sidomos pranimi i fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese sepse i akuzuari nga fillimi i ndjekjes penale ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes dhe në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Prandaj, Gjykata e Apelit në mungesë të rrethanave rënduese të përmendura si më lartë dhe vlerësimin e drejtë të rrethanave lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë dhe të pretenduara nga mbrojtja, sidomos rrethanave veçanërisht lehtësuese në anën e të akuzuarit si pranimi i fajësisë dhe bashkëpunimi i të akuzuarit me organet e ndjekjes, pendimin e shprehur, më parë i pa dënuar, pastaj rrethanat familjare, është i martuar dhe baba i dy fëmijëve, ushqyes i vetëm i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se dënimi i cili i është shqiptuar të akuzuarit nga kjo Gjykatë në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se është në funksion të preventivës gjeneralë, posaçërisht të asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorit për rrethanat rënduese që ai u referohet në ankesë për ashpërsimin e dënimit, gjen se janë të pabazuara sepse ashtu si u tha edhe më lartë rrezikshmëria shoqërore e veprës së kryer nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese, ndërkaq rrethanat tjera si : shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, shkallën e lartë të dashjes

për kryerjen e veprës penale, rrethanat me të cilat është kryer vepra penale, prokurori në ankesë vetëm i numëron, por nuk jep asnjë arsye tjetër që këto rrethana ndërlidhen me të akuzuarin dhe veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Për këto arsye ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit u aprovuan si të bazuara, ndërsa ankesa e prokurorit të PTH në Mitrovicë u refuzua si e pabazuar.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 par. 1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVË**

**PAKR.nr.178/2017 me date 28 prill 2017**

**Procesmbajtës,**

Eroll Gashi

**Anëtarët e kolegjit,**

Tonka Berishaj\_\_\_\_\_

Fllanza Kadiu\_\_\_\_\_

**Kryetari i kolegjit,**

Xhevdet Abazi